



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LEZHË
KRYETARI

Nr. 5228 Prot.

Datë, 28.03 .2021

Nr.....Datë 28.03 2021

P/VENDIM

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË, NR.172 DATË 27.11.2020 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2021 DHE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2021-2023"

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, pika 2, neni 54 gërma ç, dhe "dh", ligjit Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave ,Nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë.Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.172,datë 27.1.2020 "Për miratimin e buxhetit për viti 2021 dhe të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin Këshillit të Bashkisë,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e një shtesë në pikën 3, "Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Lezhë dhe institucioneve të varësisë 2021, të Vkb-së Nr.172 datë 27.11.2020 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2021 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023" konkretisht si më poshtë:
 - 1.1 Shtohet numri i punonjësve me kontratë në programin buxhetor si më poshtë:
 - Në programin buxhetor "10140" "Kujdesi Social (PAK)" shtohen 5 punonjës me kontratë sipas afatit të zbatimit të projektit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Pjerin NDREU

